



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

**V E N D I M
P Ë R**

**VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE
NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLIN BASHKIAK BELSH, NË ZBATIM TË LIGJIT
NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN,
EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 11, i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,



Nr . 195 i vendimit Datë 23.04.2019 e vendimit Ora 13:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VËREN

Këshilli i Bashkisë Belsh, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave, për arsye të dorëheqjeve ose humbjes së mandatit të disa këshilltarëve.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidatët për këshilltarë përcaktuar në bazë të listave shumëmemërore të subjekteve përkatëse, kanë plotësuar e depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, të 2 (dy) kandidatëve për anëtarë në Këshillin Bashkiak Belsh, rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar dënime penale, masa sigurimi personal, urdhër kërkimi ndërkombëtar, dëbime.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2463 prot., datë 19.04.2019 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2462 prot., datë 19.04.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtarë në Këshillin Bashkiak Belsh, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Me shkresën nr. V-1199/1 prot., datë 19.04.2019, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për 2 (dy) kandidatët për anëtarë në Këshillin Bashkiak Belsh, sipas së cilës rezultojnë të padënuar nga gjykatat shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë.

Referuar nenit 49 të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli bashkiak ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për 2 (dy) kandidatët për këshilltarë bashkie, të dhënat e të cilëve nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatëve në funksionin e këshilltarit, duhet vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga Këshilli Bashkiak Belsh dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme për verifikim.

PËR KËTO ARSYE:



Nr. 195 i vendimit Datë 23.04.2019 e vendimit Ora 13:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", e ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

VENDOSI:

1. Njoftimin e Këshillit Bashkiak Belsh, për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit kandidatëve të listave shumëmemërore, për plotësimin e vendeve vakant në Këshillin Bashkiak, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr . 195 i vendimit Datë 23.04.2019 e vendimit Ora 13:00 e vendimit

"Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillin Bashkiak Belsh, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".